

Hysen AZEMI

PREMORIJA E VASO PASHËS MBI LIDHJEN E PRIZRENIT

1.VASO PASHA

Populli Shqiptar ka qenë gjithnji komb fund e krye luftar dhe origjina e tij pellazge nuk i mohohet kurr.

Është edhe sot ai që ka qen 40 shekuj më par, popull i përmendur në këngët e Homerit nuk ka qytetrim të përparuem as zhvillim të plot.

Nga mungesa e tokëve pjellore të mjafta u shterngue të kufizohet në jeten blegtorale, duke u knaq me pak e duke pas si të vetmen pasuni, pushken dhe traditat e tj Malet lirin, kombsin tri gjana kto ku i rri gjithji mendja nuk do të kish mujt me i rujtun pa therrorina.

As fet që ka ndrrue,e as mendimet që ka këmbye nuk kan mujtun me ndryshua mënyren së tij Asht lidh në të shkumen me gjith fuqin dhe karakterit të vet duke mbet i lidhun në të shkumen me gjith fuqin e karakterit të vet duke mbet I lidhun në te ndonse kan kalue 40 shekuj mbi krye të ti.

Duke u bazue në vleften ushtarake, në traditat e trmnin e ti e në krye lartsin që e ka kombsin e vet, populli shqiptar nuk do ti nenshtrohet sundimit të një populli të vogel,që është primitiv e ka të të drejt të habitet; nuk perulet parpara madhshtis e madhësis duhet një Aleksander e një Jul Cezar, një Napoleon e një Muhamed i II-të që të flasi për nenshtrim.

Vogëlsija nuk e imponon, përkundrazi shqiptari e perbuz.

Greqija, Mali i Zi dhe Serbia jan shtete shum të vogëla që të pretendoj pushtimin e Shqipnis.

Ndergjegjëja e popullit Shqiptar ngriti krye kunder ides së nenshtrimit nga ana e një fuqie që sësht fuqi peranderije e as ka tradita e trimni ushtarake.

Kjo ndjenjë është origjina e Lidhjes shqiptare të Prizrenit. Ideja e krijimit të saj nuk u frymzue prej kerkuj; lindi vetvetiu në ndërgjegjëjen e qdo Shqiptari po ne një qast.

Qdo krahin ka degue në Prizren delegatet e vet e kta nuk kan qen krenë, as njerz me influence folen në emer të popullit shqiptar pseë ishin ata vet populli dhe shpirti i tyre e ndjeu të fyren e rënd që po i behej kombsis shqiptare e burmis së tyre ushtarake.

Ata kishin në vete një shkendi elektriku që i vuni zjarrin minavet dhe lëkundjeve të perhapuna lindi në qdo zemer shqiptare marrveshja spontane dhe instiktive që quhet „Lidhja e Prizrenit”.

Mbasi zgjun ndërgjegjen kombtare delegatet e Prizrenit u zhduken, hyn përseri në gjirin e popullit, prej të cilit kishin dal dhe sot kerkohen kot, sepse as duket, as kapen pasi gjdo krye, qdo plak katundi e qdo kryetar familje jan ba bajraktar e ushtri një nga ndërgjegja kombtare marrin urdhnat si kren dhe binden si ushtarë.

Prova e pa mohueshme e kti fakti është vrasja e Avdullah Pash Drenit, prej Gjakove një nga krenet ma të shquem të Shqipëris së veriut.

Ky duke qen i dyshimt se pranoj pikpamjen e Mehmet Ali Pashes dhe punonte në dam të nderit dhe dinjitetit të kombit u vra i pari aj prej bashkpuntorve të vet dhe kujtoj se qdo kryetar që do vepronte per të ceneue ose me ndryshue ndjenjat kombtare do të psonte fatin e Avdullah Pashes dhe të tjerve që u vran me Mehmet Aliun.

Nuk e parashikoj dot fundin e ksaj rruge as fatin që i është rezervue kombit Shqiptar, por ai fat që del prej kti tufani asht trubullimi i ndërgjegjes së popullit është zani i ti që proteston kunder vendimit të kongresit të Berlinit.

Natyrisht Europa së nifte as Shqipnin as Shqiptaret. Duke urdhnuue coptimin e tokave të tyre nuk murr para sysh aspiratat e ksaj race të pastër as rrafjen e zemres së saj fisnike dhe bujare. Me gjithë cilësit dhe karakterin kalorës populli shqiptar nuk e shef veten të aftë, që të luftoj kunder vullnetit të Europës, por ka ndërgjegjen e bindjes dhe i nderon stergjyshit e ti e do të vdesi pa u ankue. Ma në fund kryengritësit mësyen dhe zaptuen kullen vran ma par Avdullah Pashen e mandej Mehmet Ali Pashen, kur po delte ky të dorzohej.

Koken e Mehmet Ali Pashes kryengritsat e vun në mbaje shtize dhe e shtiten neper popull 06 shtator 1878.

Mbas ksaj ngjarje „LIDHJA SHQIPTARE, morri fuqi të perhaps gjith kah neper Shqipëri.

KONFLIKTI PËR QËSHTJE KUFIJSH ME MAL TË ZI E E ME GREQI

Në të zëgjidhun të qështjevet për një revizim kufijsh në tokat otomane kahë ana e Shqipnis,për qka ban fjalë traktati i Berlinit,u qfaqen shum veshtirsina.

Traktati i Berlinit për veq që Malit-të-Zi i jep krahinat e Plaves e të Gucis në anen tjetër edhe Greqija i premton rrypin e tokes deri në vin që i formojn lumejt e Kallamasit e të Sallamarjes kah ana e Janines e Thesalis.

Pse edhe Greqija nuk don me ndejt e qet në kët kacafytje, por don edhe ajo pjesen e saj.

Por qka se traktati i Berlinit kishte vu per kusht për kto pjes të kufinit një marrveshje bilaterale në medis të qeverive Turke dhe Greke popullata që banonte ndër kto krahina përbëhej në shumicen prej saj prej Grekësh, Vllëhësh e shqiptarësh krishtenë,kurse ata kah ana e Thesalis ishin Turq e kah ana e Janines Tosk muslimanë.

Vija e drejt midis në medis të Kallamasit e të grykes (embouchure) të Sallamarajes prekte rrëshqit qytetin e Janines, aq sa mund të nderlikonte edhe ma konfliktin e kufinit qashtja se kuj duhej ti rrinte ky qytet.

Bile ky konflikt qe qfaq edhe ma parë në medis të Grekvet e Shqiptarvet në një anë e në midis të Turqëvet e Shqiptarve n anë tjetër. Qyteti i Janines ka mjaft krishtenë e rrethet jan të banume krejtësisht krejt krishtenësh.

Në kallndoria e vjetit 1879 kur do të mlidhet komisjoni për caktimin e kufijvet Turko-Grekë, Grekët i paraqiten një kerkes Ambasadorve të Mretnivet të Mdhaja në Stamboll,me të cilen kerkojshin aneksimin e Janines e Greqis.

Në anen tjetër bejlerët e Shqipnis së Jugut ishin marr vesht ndermje vedi për një manifestim paqsuer kundra asaj kerkesë të Grekvet, tuej mos kundershTue cedimin e ndonji pjese toke Greqis kah ana e Thesalis,mbasi aty nuk kishte popullat Shqiptare.

Kështu, Lidhja e Shipnis së Jugut, e fermueme në fillim me mbrojtë vetëm Janinen,erdh gjithnji tuej u zgjanue, aq sa në fruer të vjetit 1879 u shndrrue në një Lidhje Shqiptare të Përgjithshme, nën sqetulla të së ciles futen shum qytete të Shqipnis së Mesme, si Berati, Durrësi, Prizreni, Shkodra etj.

Ky bashkim morri të hapun deri në Manastir porta e Lart shiqonte Lidhjen edhe me sy të mire, edhe si të rrezikshme; por me gjith këte nuk guxonte me marr kundra saj ndonji masë të ashpër, pse akoma mbante gjallë para syshë incidentin fatkeq të Jakovës (1).

Lidhja Shqiptare jo vetëm qi e kundreshtoj rreptas tentativen e Europes me ja dhan toka Malit-të-Zi, por punoj për krijim të një shteti shqiptar autonom qi do ti përfshinte të gjitha krahinat ku flitej gjuha shqipe dhe ato pjesa tokash të vilajeteve të Selanikut e të Kosovës me shumica shqiptare.

Kryeqyteti i kti shteti të ri autonom do të ishte Ohri.

Kështu që ball Berelinit u krijue bashkimi i të tan shqiptarvet, tosk e gegë pë një qëllim të njëjtë, bashkim në të cilin mandej morrën pjesë edhe katolikët e Shqipnis së Eper.

Përpara rezistencën shqiptare shkojshin rryetas bisedimet në medis Mretnivet të Mdhaja për kufijt e veriut e të Jugut.

Lidhja Shqiptare i qonte nga Gucija letra kërcnuese Komisionit Nderkombtar të caktimit të Kufijvet dhe i thonte se do ta lajshin Shqiptaret me gjakun e tyne qdo pllamb tokë qi aj Komisjon mendonte me i lëshue Malit-te-Zi.

Në gusht të vjetit 1879 Mali-I-Zi lypi nga Qeverija Otomane, pa pritë vendimin e Komisionit të Kufjvet lirimin e Plaves e të Gucis.

Qeverija Otomane në fakt liroj ato dy Krahina, e per ma tepër lshoj një proklamatë me të cilen ftonte popullin mos me kundershue vendimin e Berlinit dhe e kshillonte mos me derdh gjak më kot e pa dobi, pse kjo punë do të qe në kundershim edhe me urdhnimet e Kuranit.

Veq këtyne i premtonte popullit në proklamatë se do ti jepte tokë e farë atyne që do ti emigrojshin dhe do tu falte taksat për dhjet vjet kohë.

Për vetë Qeveris Otomane i vijnte randë me pushtue ato dy krahina me ushtrina të veta e mandej me ja lirue Malazezvet.

Në dimen të vjetit 1879-1880 u vetetuen luftimet e pergjakshme në medis Shqiptarësh e Malazezësh, kshtu potes së Lart iu desht me ba një tjetër propozim; Ti jepeshin Malit të Zi Kuqi e Kraja, në vend të Plaves e Gucis.

Por dhe prej kti propozimi hoq dorë, tue i ba një permirsim kufinit në mënyr që pjesa e këtyne krahinavet e banueme prej muslimanësh ti mbetej Turqis.

(1) Si u përmend edhe ma nalt, në shpi të Abdullah Pashes (Drenit) që vra me 6 shtatuer 1878 prej shqiptarësh Mehmet Ali Pasha, që që që në Shipni prej Sulltanit me i zbut shqiptaret.

Shqiptaret musliman numri i të cilve deri në fund të prillit u kap deri në 10.000 pritëshin me ardh në Tuzë dhe Dibranet e Manastirasit.

Por qëka se armet e këtyne shqiptarvet nuk ishin të perfekuonume, komiteti katolik i ju dha buk 2000 vetvet në ditë dhe në Tuzë qoj miser për 6000 vetë hapi edhe një fushat ndihme ku u mlodhen 600.000 grosh.

Me sot e me neser pritej që Shqiptaret tu bijshin Malazetvet dhe muslimanet e Podgorices, vend ky që e ke aneksue së vonit Malitë-Zi filluen me que krye.

Turqija bante veshet e shurdhë kunra vepres agresive të Lidhjes Shqiptare dhe Europa nuk e shterngonte Turqin me rudhë gucinin e Shqiptarvet mbasi tash vehej në rrezik fati i katolikvet.

Sq mramit shtetet e Mdhaja hoqen dorë nga protokoli që kembente Plaven e Gucin me tokat bri Cemit, mbasi aj protokol nuk mund të aplikohet vullnetisht dhe kerkuen me gjet një modus-vivendi tjetër.

Anglija kah fundi i majit 1880 kërkoi që të ngarkoheshin Konzuli i saj dhe aj i Austrisë në Shkoder me u caktue bashkarisht se cilat krahina tjera mund të i lëshoheshin Malitë-Zi si shperblim në vend të Plaves etë Gucis mbasi do të njëfshin më mirë gjendjen e vendit.

Kët propozim e pelqej edhe Qeverija Austro-Hungare konzujt në fjal hartuen menjëher një plan sambas të cilit në vend të Plaves e Gucis dhe të Hotit e të Grudes do ti cedohej Malitë-Zi rrypina e tokes gjat bregut të Adrijatikut deri te gryka e Bunes me një permirsim të vogel të kufinit në breg të liqenit të Shkodres.

Mirë po Lidhja Shqiptare nuk e pranoi as këtë modus-vivendi, mbasi edhe banoret e ksaj rrypine ishin shqiptarë muslimanë dhe katolikë.

Duhet dijt se këtë rrypinë toke hynte dhe porti i Ulqinit shqiptar por shqiptaret e Ulqinit e të rretheve nuk ishin të fortë si banoret e maleve, e pra Ulqinit mund ti huhej mrenda ma lehtë si për toke ashtu edhe për detë.

Mandej Anglija mendonte se mund të qohet në lima të Ulqinit dhe një flotë nderkombtare, për t'i shternuge Shqiptarët me dhunë me idorzue ulqinin Malazetvet. Europa përpiqej si e si t'i sbusi e t'i qetsojë Shqiptarët, tue u premte këtyne se mund t'a bindete Turqin

Me 26 shtatuer Mretnit e Mdhaja i ju gjegjen notës së Portes. Por kjo not nuk përmbante një not të perpiktë.

Atëherë Sulltani Abdulhamid premtoj se do ta merrte vetë premtoj se do ta merrte vetë qeshtjen në dorë dhe do zgjidhte konfliktin.

Ky deshir i Sulltanit iu njoftue Mretnive të Mdhaja me një notë të Portes qi mbante daten 3 Tetuer.

Sulltani me at not kërkont dhe një afat, të cilin ja prenuan Mretnit e Mdhaja mbasi afati i dhanun Sulltanit u sos e gja nuk u perfundue, atëher ministri i jashtëm i Turqis u dergoj një të re Kancalarive te Mretnivet të mdhaja, tue kerkue zgjidhjen bashkarisht (en bloc) të tana këtyne qështjeve të mbetuna pezull deri më sot;

Kufijt e Malit-të-Zi e të Grekis, Armenija, financat e pergjithësisht qashtja e reformavet dhe premtoj Ministri në fjalë se do të hynte me një her në bisedim për kto qashtje tuej theksue dhe një herë si kusht se demonstratat navale duhet shporen.

Një kohsisht Anglija tentonte me pushtue Izmirin me floten nderkombtare dhe perpiqej për këte qellim pran kancalirivet tjera.

Kët tentativë të Anglis e kundershtoj Austri-Hungarija.

Me 11 Tetuer Porta e Nalt lajmronte se ishte gati me lirue Ulqinin dhe se kishte dhan urdhëna taksative për të mbajtur të rendit e të qetsis me rastin e lirimt.

Fill mbas këtij lajmrimit u hap bisedimi i formalitetevet të lirimt të Ulqinit në medis të Turqis e Malit-të-Zi.

Dhe në fakt me 22 Tetuer 1880 u dha urdhen organevet të qeveris me lirue mrenda 6 ditëvet.

Dorzimi i Ulqinit nuk u krye me aq lehtësi.

Pozitat strategjike të Ulqinit, të cilat do të pushtonte Mali i Zi ishin nder duer të ushtarvet Turk një pjes e të Shqiptarvet një pjes tjeter.

Duhej që ushtria Turke të nderhynte për lirimin edhe të pjese që kishin Shqiptaret.

Mirë po komiteti i Ulqinit i Lidhjes Shqiptare lajmroj Konzujt në Shkoder se do ta qëllonte Ushttrin Turke në rastë se ajo do të luante kambë për me zaptue pozitat që i mbajshin Shqiptaret.

Dëshira e Sulltanit qe që mos ti vihej pushka Shqiptarëvet. Por këte shteg Qeverija Turke e kishte pisk punen. Kështu ju desht domosdo me que Dervish Pashen me 18 bataljone nën kpomanden e tij dhe me msye Shqiptarëvet.

Undez lufat e Shqiptaret i mbrojtën me trimni shum pozita të tyne.

Lidhja Shqiptare (komitetet e Shkodres katolike muslimane)lypi prej Dervish Pashes një afat per lirim të Ulqinit,për të pas kështu kohë me u kshillue me Komitetet tjera për masat që lypseshin me u marr përpara ksaj ghendjeje.

Dervish Pasha u soll mjaft eger ndaj Shqiptarëvet. U perpoq mjaft me i shti në dorë me dredhina krenet e Lidhjes.

Bile i ftoj për një marrveshtje, por krenet nuk ju gjegjen fteses së tij.Vet Dervish Pasha ndodhej në Shkoder.

Këtu shpalli vet rrethimin me 22 Nanduer 1880, dhe mandej u nios për në Ulqin.

Ktu thirri perfaqsuesat e Malit të Zi me nenshkrue Ujdin e dorzimit.

Me 23 Nanduer hyni në Ulqin mbas nji luftimi që pat me një qet Shqiptare afër 500 vetesh ndër rrethet e Moqares.

Ulqinaket quan flamur të Bardhë. Me 25 të nandurit u nënshkrua ujdija e dorzimit ,e me të nesermen u dorzue Ulqini.

Ushtria Malazeze zyrtarisht hyni në Ulqin me 27 te Nanduerit.

Në kët koh flota nderkombtare gjendej në limanin të Ulqinit.

Konflikti nuk u mbyll, me gjithëse Ulqini u pushtue prej Malazezëvet.

Vendimi për caktimin e kufijvet që shtriheshin në medis të grykes se Buenes e të liqenit të Shkodres, u formue menjëher një komision nderkombtar i cili mujt me krye punë kah fundi i Kallnorit 1881.

Caktimi i pjesës së kufinit në veri-lindje të liqenit hasi ndër pengime, e vetëm në vitin 1884 morri fund caktimi edhe i ksaj pjese të kufinit .

Kështu ngjau edhe për kufijt me Grekin.Do me thanë Shqiptaret ban edhe per kufij e

ksaj ane po atë rezistencë qi ban për kufijt nga ana e Mlit-të-Zi.Veqse rezistenca këtu nuk përfundoj me një operacion ushtarak.

Në fillim u morren vesht direkt Turqija me Grekin.

Turqija propozoj nji vi kufini qi nuk i përshtatej atij të revizuen në Art.13 të traktatit të Berlinit.

Ky propozim qe ba në 1879 vertet zgjanohej npër kët propozim kufini Grek, por zgjanim për Grekin ishte i pa randësi pse limanet e Nartes e të Gollosit Turqija i mbante për vehte.

Dhe në fakt per Turkin nuk mbeteshin rruga tjetër ma të perdorsheme se rrugat e Pervezës se të Gollosit qi ti qojn në Shqipni e në Thesali.

Shqiptarët thojshin se do ti mbrojshin me gjak Janinen, Pervezën e Narten dhe negociatat e nisuna në medis Turkis e Grekis u

pren, dhe kështu Qeverija Greke me një notë të datueme me 9 mars 1881 kërkoj intervenimin e Pushteteve të Mdhaja.

Franca me e para morri në konsideratë kerkimet Greke dhe propozoj një nderhymje të shteteve të Mdhaja një konferencë të diplomatëve të tyre në Stambollë.

Ky propozim i Frances u pranue dhe bisedimet u hapen në Stambollë.

Si objekt i bisedimesh në at konferencë u vunë të gjitha qëshjtjet e marruna me Grekin.

E para së gjithash duhej perfundu se vija e shenum e kufinit në traktatat e Berlinit a duhej marrë si një punë e kryeme a por në formen e një deshire ose kshille të qfaqun me at traktat.

Në fund vija Kallamas-Sallamarja u muerr si bazë për me vijue bisedimet, në mënyr që kjo vij mund të ndryshohej në mbarim të marrveshjes së perfundueme dhe stina e dimrit krejt kaloj me bisedime propozime e projekte.

Në dhetuer 1879 Franca propozoj që Janina ti mbetej Turkis e Thesalija krejt me gjith Meqaven ti jepeshin Greqis.

Anglija në kundershitim me propozimet e Frances, në mars 1880,qfaq i mendim se qashtja e caktimit të kufinit duhej ti ngarkohen një komisioni të emnun nga Mretnit e Mdhaja qi kishin nenshkrue traktatin e Berlinit.

Propozimi i angles gjeti një jehoë të favorshme ndër kanqelaritë e Mretnive të Mdhaja,por Turkija nuk e la të lir komisionin e zgjedhun me veprue ndër zonat e kontestuese,nga friga e ndoni agjitacioni e provokimeve të populates së atyne zonavet.

Ky kundershitim i Turkis i dha shkak mledhjes së një konference në Berlin në Qershuer 1880.

Në këtë konferencë Ambasadorësh Franca ma e para propozon një vi kufini të atillë mrenda së ciles jo vetëm hynte Janina, por Grekija futej në tokat Turke ma thellse sa i caktoheshin me traktatin e Berlinit.

Kjo vi e kufinit u pranue me aspak kundershitim prej conferences së Ambasadorvet me 25 Qershuer 1880 dhe me noten identike të 25 korrikut u ftuen Turkija e Grekija me e pranue këtë vi.

Grekija natyrisht e pranoj ndërsa Turkija jo dhe kjo e fundit tuej deklarue se nuk mujt me lëshue Grekis Janinen, Meqoven e Jeni shehrin (LARISEN) u lutej mretnive të Mdhaja me hy drejtazi me te në marrveshjtje.

Mretnit e Mdhaja e rfuzun këte kërkim; por u dëftuen të gatëshme me bisedime mbi veprimet në lidhje me dorzimin e tokavet qi do ti liheshin Grekis por puna nuk eci si deshten ato.

Turkija edhe njëher u njoftoj Mreëtnive të Mdhaja se nuk mund të ja lironte kursesi ato tri qytete Grekis, dhe me noten e saj me 3 Tetuer 1880 u propozoj atyne një tjetër vi kufini,qi do të kalonte kah juglindja e qytetevet në fjalë dhe u premtoj dhe u premtoj se do tia lironte Grekis mrenda 100 ditëve tokat që do të ngeleshin mrenda këti kufini të ri.

Anglija sugjeroj mendimin me perdorë forcë kundra Turkis kët mendim e kundershtoj Austro-Hungarija.

Lordi Goschen,ambassador i Anglis në Stambollë i tha me këte rast këto fjalë ambasadorit të Austro-Hungaris; Të dy na duem ta mbajm Turkijen në këmb,por na ndryshojn metodat. Ju mendoni se mundë të realizohet kjo gja shkallë shkallë e me mjete normale, kurse un mendoj me ja imponue Turkis reformen.

Po nuk u shporr Turkija nga mentaliteti i vjetër dhe po nuk e ndreqi administraten e vet në harmoni me frymen e re, mbas kohe ka për tu shembë dhe për tu pjestue.

Qëllimi i ambasadorit Anglez me fjalet „Reforma,,e „Frym e re ,, qe me ja shti ndermend Turkis detyrimet qi kishte marr me traktatin e Berlinit.

Sidoqoftë kundra pengimevet të Turkis Grekija u pregadit me i marrë me forcë të armëvet tokat e premtueme asaj.

Por nuk mujt me i ja dal qëllimit, përpara kundershtimevet qi gjeti kjo ndërmmarrje e saj ndër Mretnit e Mdhaja.

Pse edhe Turkija ishte e gatshme sa me i rujtë tokat e saja prej sulmit eventual të Grekëvet.

Mretnit e mdhaja këshilluen Turkin që mos me i dhan shkas luftes.

Sulltani vetë i tha një ditë një Ambasadorit se vin e kufinit të caktueme prej Konferences së Ambasadorvet nuk mund ta pranonte se Qeverija e tij ishte gati me ja lëshue Grekis ato toka qi do vendoseshin në medis të tyne në baz të një akordit të ri.

Kjo fjalë e Sulltanit u dha dor ë disa Mretnive me hap një bisedim të ri dhe Franca e para,në dhetuer 1880 i propozoj Grekis që ta bindëte kjo vetë Turkin për emnin të një Komisioni arbitrazh i ngarkuem me qështjen e caktimit të kufijvet.

Turkija e pranoj kët propozim,por jo sambas formulas së Frances,d.m.th.me hy në bisedim drejtazi me Grekin,vetëm me

Ambasadorët e Stambolles, mbasi me Grekin qi i kërcnohej me luftë e mendonte të pa mundëshme mrijtjen në marrveshtje.

Në këte kohë e siper Mretnit e Mdhaja e morren seriozisht mnë bisedim projektin e Frances për arbitrazhin dhe vendosen me i ja porositë të dy palvet kundertshtare proceduren e arbitrazhit të pranue me prej tyne.

Por këti arbitrazhi nuk iu afruen as Grekija as Turkija sidomos Grekija pretendonte se në rasë të pranimit të këtij arbitrazhi do të dilte ma e damtueme se sa ishte parapa në Konferencen e Berlinit të mbajtun në Korrik 1880.

Rishtazi u happen bisedime në medis të Mretnivet të Mdhaja; dhe i autorizuen ma në fund Ambasadoret e tyne në Stambollë me nis negociatat me Turkin në bazë të një note që kishte dhanë ajo me 14 të Kallnorit 1881 për një revizim të kufinit.

Me 8 Mars u ba para mledhje, në të cilen muarren pjesë dhe perfaqsesit e Turkis dhe në të paren seanc të mledhjes disa nga Ambasadoret propozuen me ja dhanë Grekis Kreten në vend të një pjese të hinterlandit të Janines.

Anglija nuk ju afrue këti propozimi, me gjithë qe Rurkija e pelqej; por me kusht që mbasi të kishte lirue nji-herit Kreten nukë do të cedonte as një pllambë tokë nga Thesalija e nga Janina.

Kët kusht e refuzuen të gjithë Ambasadoret por kët propozim të ri e kundertshtuen dhe muslimanet e Kretës, por sa muarrem vesh se po flitej mbi fatin e vendit të tyne.

Për limanin e Pervezes, qi ishte dera e qytetit të vilajetit të Janines, Turqt ngulshin këmbë mos me ja lëshue Grekis.

Mbasi mbi këte propozim nuk qe e mundun u marrë vesht Turkija shtroj një tjetër propozim; Të bahej një revizim kufini në mënyr që Perveza, Janina e Moqava ti mbeteshin Turkis; Gollasi, Larisa e Narta ti leheshin Grekis.

Ky propozim u pranue prej Ambasadorëvet, por me një ndryshim qi edhe Punta, nji vendë ky karshi Pervezës ti lihej Grekis dhe të shembeshin fortifikimet e Prevezës.

Grekija u këshillue me dhan zotime tolerance për muslimanet që do të mbeteshin nën sundimin e saj dhe me mbet e pa prekun pasunija e tyre.

Ky modus-vivendi qe deri diku i logjikshëm dhe i jepte dorë edhe Grekis; pse asaj i rrijshin pellgu pjelluer i Thesalis krejt dhe një pjes e Janines e banueme ma tepër prej Grekësh se sa prej Shqiptarvet.

Por Greket i kishin pasë vu synin me kohë pjesen ma të madhe të Shqipnis së Jugut, qi e konsiderojshin si të veten.

Grekija e refuzoj at modus-vivendi dhe lypi që ti ndëgjohej edhe asaj fjala, si i ju ndëgjue Turkis, para se me u dhan vendimi i fundit prej Ambasadorëvet.

Grekët në anen tjetër pregaditeshin me ju hudh Turkut për me i pushtue vendet e kontestue me tuj kujtue se në këtë ndermarrje kishin me vet Anglinë.

Mreti dhe Qeverija Greke hesitojshin kurse populli Grek i kercnoheshin Qeveris dhe lypshin luft kundra Turkisë..

Fuqit e mdhaja ishin futun thellë ndër punet e Grekis e pra ishin për to pun e vështirë me kthye mbrapshtë.

Kështu me një notë të përbashkët të 8 Prillit 1881 Qi Ambasadorët në Athinë i dha qeveris Greke, kërkuen prej saj me i shtrud vendimevet të Konferencës së Ambasadorëvet të Stambollit, të cilat vendime kishin një karakter definitive dhe zëjshin vendin e atyne të Berlinit mbasi kështu e donte interesi i sigurimit të paqit botnuer.

Dhe i premtuen Grekis se po ta pranonte ajo këtë masë të fundit do ta mbikqyrshin ato vetë zbatimin e mirë të vendimevet.

Nota e mbram kishte një tingllim të ashpër dhe ishte e shkrueme me një stil serijoz.

Prandej Mreti i Grekis u shterngue me e ulë kryt para asaj note megjithëse Anglija anoj në fillim kahë Grekija mrapa kur po vijojshin bisedimet sundoj në medis të fuqivet të Mdhaja një atmosfer harmonije për tu admirue.

Qeverija Greke me noten e saj 12 Prill 1881 perseriti dhe një herë ankimet esaja të vjetra, dhe njoftoj se do ti pushtonte tokat qi ju ceduen asaj, tuj dhan muslimanvet lirin e fes e të zotimit të pasunis. Po me këtë notë pyetëte Grekija se në cilen datë do ti liroheshin ato tokë nga Turkija dhe deklaronte se fatin e Grekëvevet qi mbeteshin jasht kufijëvevet të Grekis ia lëshonte në dorë të mshirës së drejtësis së Fuqive të Mdhaja.

Kështu Qeverija Greke, edhe pse një mënyr dredhacake, ma në fund i pranoj vendimet e konferencës së Amasadorvet në Stambollë. Me 19 Prill 1881 iu komunikue Qeveris Turke një notë me të cilen ftohej me dorzimine tokave të vendosuna, dhe ajo njoftoj se kishte emnue perfaqësuesit e saj për komisijon të dorzimit.

Në fund, me 24 Maj 1881 u nënshkrue prej përfaqësëvevet të Fuqive respective protokoli qi përmbante modalitetet e dorzimit.

Lëshimi i Nartes Grekis siq ishte vendosun në Stambollë, për Lidhjen Shqiptare qe një grushtë.

„Mbasi u shpall botnisht ky vendim, Komiteti i Gegnis së Lidhjes Shqiptare i shkroj Komitetit të Toskënis qi ti pushtojshin me forca shqiptare viset qi do ti liroheshin Grekis dhe i premtoj ndihma.

Kështu mendonte Lidhja Shqiptare me ja marrë Qeveris Turke nga dora punët e Shqipënis, për zgjidhjen e së cilavet ajo nuk u tregue e zoja.

Por sa u njoftue porta e Lart për kët vendim të Shqiptarëve, iu duk tashti e nevojshme me marrë masa decidive kunra Lidhjes dhe e qoj për këte qëllim Dervish Pashen në Prizren.

Shqiptaret e priten me pushkë Dervish Pashen dhe në Ferizoviq u ba një ndeshje në medis të Shqiptarëve e të ushtris Turke.

Shqiptarët u thyen e Drvish Pasha hyni në Prizren dhe prej aty urdhënoj Valin e Janines me i arrestue anëtarët e Komitetit të Shqipnis së Mesme e të Jugut.

Valiu i Janines ftoj mbas ati urdhëni parsine Janines, Vlonës, Beratit e Pervezës dhe i arrestoj dhe i dergon në Qanakala.

Megjithëse popullata e alarmueme, nuk kundërshton në dorzimin e Nartës Grekis.

Qetsija në Shipni mujtji me u vendos vetëm mbas dy vjetëve dhe në kët koh Sulltani dha një amnesty të pergjithëshme.

